



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 10043 / prot.

Tiranë, më 08 . 7 . 2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.656/1, datë 19.06.2014.

**SHOQËRISË “GOREZI” SH.P.K
Poliçan, Skrapar, Qarku Berat.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Gorezi” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.656/1, datë 19.06.2014, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Skrapar.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.6425 prot., datë 18.07.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.10043 prot., datë 18.07.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.656/1, datë 19.06.2014, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Skrapar, për arsye se nuk është paguar garancia financiare e rehabilitimit të mjedisit për vitin 2017 – 2018, siç është përcaktuar në nenin 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.656/1, datë 19.06.2014, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Skrapar, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.656/1, datë 19.06.2014, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Skrapar.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

